



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, *Përgjegjës i sektorit të IT-së*, në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Rektorat.

Përgjegjësi i sektorit të IT-së përgjigjet për:

- menaxhimin dhe mbarëvajtjen e burimeve informatike dhe infrastrukturës, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të informacionit, rrjetin kompjuterik hardware (pajisjet kompjuterike) dhe software (programet) si dhe mjetet e tjera të komunikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi);
- nxjerr të dhëna statistikore të programuara për MAS dhe institucione të tjera;
- përgjegjës për zgjidhjen teknike dhe ligjore të problematikave që lindin brenda sektorit;
- përgjegjës në lidhje me kompetencat e specialistëve të sektorit për ndarjen e detyrave dhe zbatimin e tyre;
- kryen çdo detyre tjetër të ngarkuar nga eprorët

Kandidatët duhet të plotësojnë kritere të përgjithshme e të veçanta për këtë pozicion pune.

Kriteret e përgjithshme:

- të zotërojë diplomë të ciklit (nivelit) të dytë të studimeve Master, në fushën e informatikës/Teknologjisë së Informacionit.
- të ketë përvojë pune.
- të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuuar me dokumentacion.
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite pune në fushën e IT-së
- të ketë kryer trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse
- përvoja në IAL përbën avantazh
- të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë **në rrugë postare** nga data **10.07.2023** deri më **19.07.2023** dokumentacionin e mëposhtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Letër motivimi për pozicionin e Përgjegjës të sektorit të IT-së;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njësuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njësuar me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin;
- Raport i aftësisë për punë, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Të interesuarit duhet të dërgojnë **në rrugë postare brenda afatit** dokumentacionin e tyre në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës së *Përgjegjës IT***

Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve paraprakisht dhe më pas ata do të nënshtohen intervistës me gojë. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UE-së, Brenda periudhës (21.07.2023 - 31.07.2023). Kandidatët konkures do të njoftohen elektronikisht brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe shpallja/njoftimi i fituesit.